

Tiranë më 19/11/2012

***Cilësia e kontabilitetit dhe pasqyrave financiare – element jetik për sfidat e të ardhmes.***

***Arben Malaj***

***Fjala e mbajtur në konferencën e “Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”***

**Të nderuar pjesmarrës,**

Duke ju falenderuar për ftesën, duke ju uruar për aktivitetin, më lejoni t’iu shpreh mirënjohjen time të veçantë për përgjegjësinë dhe vizionin me të cilin i jeni përkushtuar këtij profesioni sa të rëndësishëm aq edhe fisnik.

Në këtë sallë janë bashkë shumë nga profesorët më të nderuar, janë shumë nga kolegët e mi të shkollës, janë shumë nga kolegët e mi në mandatet publike si lektor, deputet, ministër. Ju falenderoj të gjithëve.

100 vjetori i pavarësisë së vendit është momenti më i mirë, për të analizuar të shkuarën në funksion të së ardhmes, për të analizuar arritjet, mos arritjet duke i vënë këto analiza në shërbim të sfidave.

Personalisht kam qënë me fat që kam mundur të njihem me shkencën e kontabilitetit që në hapat e para të arsimit tim, duke studiuar në shkollën e mesme Ekonomike në Vlorë, me një staf pedagogësh të talentuar. Kam qënë me fat që në fillim kam punuar me ekspert të kontabilitetit. Profesorët e Fakultetit të Ekonomisë në Tiranë, Departamenti i Kontabilitetit kishte shumë nga personalitetet që nderoheshin jo vetëm nga studentët por edhe nga vetë kolegët e tyre. Si Ministër i Financave shumë shpejtë do të kuptoja se në kontabilitet kishte profesorë të nderuar nga Univeristeti Bujqesore i Kamzës. Këtë e kuptova jo nga një luftë midis tyre por nga një respekt reciprok i ndërsjellët midis tyre.

Sa herë që më duhej të këshillohesha për reformat në fushën e kontabilitetit, sa herë që duhet të krijoja ndonjë grup pune, sa herë duhet të emëroja në mandate të ndryshme publike ekspert nga fusha e kontabilitetit, do të duhesha të përfshija dhe respektoja mendimin e kolegëve dhe studentëve të tyre nga të dy departamentet e kontabilitetit të Tiranës dhe Kamzës.

Ka qënë shumë e vështirë dhe besoj është akoma më e vështirë të përzgjedhësh midis shumë të mirëve, sic është sot stafi akademik i profesorëve të kontabilitetit. Të shpresoj që në vendimet e mia të kem përzgjedhur më të mirët.

Në themelimin e Këshilit Kombëtarë të Kontabilitetit, në fillim të vitit 2005, u përzgjedhën disa nga kolegët më të mirë nga dy këto 2 fakultete të respektuara.

Miratimi i ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe krijimi i Këshilit Kombëtarë të Kontabilitetit janë dy momente të rëndësishme në historinë dhe zhvillimin e kontabilitetit, pas viteve 90.

**Sa herë që një vend ka një përvjetor historik aq herë është mundësia që të mësojmë nga e kaluara dhe të inspirohemi nga e ardhmja.**

**Nëqoftëse këtë angazhim pozitiv e bëjmë çdo ditë të gjithë dhe në çdo angazhim familjar, mandat publik dhe privat aq më të mëdha janë sinergjitë pozitive që krijohen, aq më të mundëshme dhe solide bëhen arritjet, aq më të qarta por edhe të arritshme bëhen sfidat e 100 vjetorëve të tjerë.**

Ndoshta ky do të jetë edhe objekti i kësaj konferece të veçantë ndaj dhe falenderimi im është i vecantë për organizatorët e saj dhe për të gjithë ju.

Sot më shume se kurrë po diskutohet për sfidat e së ardhmes, ekonomia globale është bërë më e hapur, më e ndërlydhur dhe më konkurruese.

Sot më shumë se kurrë është rritur fatkeqësisht dëshira për pasurim të shpejtë. Sot konkurrenca abuzive është rritur. Sot mundësia për t’u zhvilluar kushtëzohet gjithnjë e më shumë nga cilësia e kapitalit njerëzor.

Vlerat humane, virtutet njerëzore, cilësitë njerëzore dhe profesionale përcaktojnë fatin e çdo familje, fatin e çdo kompanie, fatin e çdo vendi dhe çdo kombi.

Duke respektuar me fanatizëm titullin e ligjit tuaj, do të duhet të theksoj që po cilësia e kontabilitetit dhe pasqyrave financiare personale dhe familjare, të ndihmon të kuptosh se pasurimi i vërtetë i jetës vjen nga puna dhe jo nga rritja e borxheve, qofshin edhe edhe kredi të “buta”.

Po, cilësia e kontabilitetit dhe pasqyrave financiare të kompanisë të ndihmojnë të kuptosh që në hapat e para nëqoftëse një përkeqësim shkatërrues ka filluar të gërryëj suksesin apo mbijetesën e kompanisë tuaj.

Po, cilësia e kontabilitetit publik dhe pasqyrave të llogarive të ndihmojnë të kuptosh dhe të marrësh përgjegjësi kur gjendja financiare e një kompanie publike apo e llogarive publike të shtetit është në përkeqësim dhe marrja e masave organizative dhe financiare është e detyrueshme dhe nuk duhet injoruar.

Le të analizojmë dështimet e kompanive të mëdha, le të analizojmë skemat piramidale nga vendi ynë deri tek skema Madoff. Të gjitha kanë specifikat e tyre për nga fusha, për nga përmasat, për nga vendi dhe koha ku dhe kur kanë ndodhur, por të gjitha kanë një gjë të përbashkët, në të gjitha rastet janë manipuluar të dhënat e ardhura nga sistemi kontabilitetit. Të gjitha kanë manipuluar pasqyrat financiare.

Çdo menaxher i kompanive private apo publike sinjalin e parë për ecurinë dhe risqet e kompanisë së tij e merr nga sistemi i kontabilitetit, e lexon në trendin e treguesve të llogarive financiare.

Ja përse profesioni juaj është kaq i rëndësishëm, ja pse ju certifikoheni për ta ushtruar profesionin tuaj, ja pse jo vetëm një individ, jo vetëm një kompani por ekonomia e një vendi të tërë dhe fati i saj kushtëzohen ndjeshëm nga shkalla e profesionalizmit dhe sidomos nga vlerat dhe virtutet individuale të ekonomistëve në të gjitha profesionet dhe angazhimet e tyre.

Jo rastësisht në të gjitha strategjitë që u diskutuan, që janë miratuar dhe që rishikohen në mënyrë periodike si të identifikohen që në hapat e para krizat, kanë në qendër të tyre përmirësimin dhe përsosjen e sistemit të kontabilitetit dhe llogarive financiare. Kanë në qendër të tyre rritjen e edukimit publik, kanë në qendër të tyre rritjen e transparencës së kompanive dhe qeverive për llogaritë e tyre financiare.

Është e vërtetë që sot ne ekonomistët jemi me fat. Aksesin në literaturën shkencore është rritur ndjeshëm, mundësia e arsimimit, trajnimit, ritrajnimit, certifikimit kombëtarë apo ndërkombëtarë është rritur ndjeshëm edhe pse testet kudo janë bërë më të vështira.

Teknologjitë e kanë thjeshtuar hedhjen e përpunimin e të dhënave, shpejtësia e përpunimit të tyre mund të jetë në të njëjtat e sekondës, kalkulimi i analizave në raporte financiare, përpunimi në tabela dhe grafike është i pa limituar dhe me pamje impresionuese.

Është e vërtetë që tani në të qindat e sekondës dhe pas çdo veprimi kontabël, çdo menaxher mund ta ketë këtë informacion në çdo vend të botës, në çdo kohë të ditës dhe me koston më të ulët të mundshme të informimit të tij.

**Por të gjitha këto avantazhe teknologjike kanë rezultuar të pamjaftueshme për të parandaluar dhe eliminuar krizat e rënda të ndodhura në disa kompani të mëdha pse jo edhe në kontabilitetin e shteteve të veçanta, ku një rast i novacioneve të deformuara të kontabilitetit publik, që e fshehu përkohësisht krizën e saj është Greqia.**

Kjo analizë rithekson faktin se edukimi publik, se vlerat individuale të çdo të diplomuari për shkencat ekonomike janë përcaktuese për suksesin e tyre, të kompanive që zotërojnë apo punojnë dhe te vendit të tyre.

Kontabilistët duhet të ndihmojnë mirëmenxhimin e kompanive duke paralajmëruar në kohë, duke parandaluar menjëherë manipulimin dhe falsifikimin e të dhënave financiare.

Ju jeni të parët që i shikoni simptomat e problemeve dhe krizave të kompanive. Detyra juaj, përgjegjësia juaj profesionale dhe penale është që të mos i fshehni problemet, të mos i

manipuloni të dhënat, të mos bëheni pjesë e sëmundjes për përfitime dhe pasurim abuziv. Kur informaliteti rritet, kur kompanitë dhe vendi keq menxhohen, pasojat prekin të gjithë.

Unë ndihem jashtëzakonisht i nderuar të jem sot këtu bashkë me ju, ndihem shumë i nderuar që kam pasur fatin të jem studenti juaj, të jem kolegu juaj.

Ndihem i privilegjuar dhe me fat që në mandatet e mia publike e politike sfidat më janë bërë më të lehta sepse kam bashkëpunuar me profesorë të nderuar, se kam bashkëpunuar me ekspert të përkushtuar, se kam bashkëpunuar me njerëz të mrekullueshëm, njerëz plotë inspirim dhe përkushtim për profesionin e tyre dhe për vendin e tyre.

Në këtë konferencë të 100 vjetorit të vendit tonë, një mirënjohje e veçantë për të gjithë ata ekonomistë që me përkushtim dhe vizion i kanë shërbyer me modesti dhe përkushtim maksimal sfidave të vendit të tyre.

Jam shumë i bindur që ju do të jeni gjithnjë e më të dobishëm për suksesin e studenteve tuaj, për suksesin e ekonomisë sonë, për një të ardhme më të mirë të vendit tonë dhe të familjeve e fëmijëve tuaj.

Më falni që nuk përmenda ndonjë emër konkret, por në historinë 100-vjeçare të kombit tonë, në çdo moment historik të krijimit dhe konsolidimit të tij, në bashkësinë e grave dhe burrave të mençur që e themeluan shtetin shqiptar, në sfidat e 100 viteve të tij, në çdo moment të vështirë kanë spikatur dhe kane kontribuar ekonomistë të talentuar, që jo vetëm nuk kanë vënë pasuri për vete gjatë mandateve të tyre publike, por me përkushtimin dhe fisnikërinë e tyre kanë fituar një vend të veçantë dhe një nderim të përjetshëm në pasurinë më të mirë dhe më të madhe të cdo kombi, mirënjohjen e merituar për shërbimet ndaj vendit dhe kombit të tyre.

Një mirënjohje të veçantë kam edhe une sot për të gjithë ekonomistët e talentuar që i janë përkushtuar fatit të vendit të tyre shumë më tepër se fatit personal të cilin mund ta kishin vetëm materialisht më të mirë, nëqoftëse do të kishin manipuluar "kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të historisë së vendit të tyre.

Me mirënjohje të thellë, Urimet më të mira dhe më të plota, për ju dhe për vendin tonë të dashur.

Suksese konferencës tuaj.

**Sinqerisht**

Arben Malaj, Deputet.

***Profesor i Asc. i Shkencave Ekonomike***

***ish Minister i Financave***